VENDIM
Nr. 88/2015

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT TË POZICIONEVE TË PUNËS TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE (AKEP)

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 9, pika 2, dhe 10, pika 1, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", të ndryshuar, me propozimin e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP),

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Struktura e AKEP-it është sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur.
II. Organika e AKEP-it është sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur.
III. Numri i punonjësve është 73.
IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARE
Valentina Leskaj

Miratuar në datën 15.10.2015